Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01 - 536
Datë: 18.10.2018

Në mbështetje të nenit 1 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe neneve 4, 5, 6, të Udhëzimit Administrativ Nr: 28/2014 për Kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 05.10.2018 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen raportet e jashtme të verifikimit të standardeve të profesionit së bashku me të gjitha rekomandimet e paneleve të ekspertëve si standarde kombëtare të profesionit me këta emra dhe kode:

   - Operuesit e kamionëve për ngritje, me kodin 8344 dhe me nivelin III të kualifikimit sipas KKK.
   - Operuesit e impianteve të vinçave, ngritjes dhe të ngjashëm, me kodin 8343 dhe me nivelin III të kualifikimit sipas KKK.
   - Shoferët e veturave, taksive, dhe furgonave, me kodin 8322 dhe me nivelin IV të kualifikimit sipas KKK.

2. Raportet e jashtme të verifikimit të standardeve të profesionit duhet t'i dërgohen KAAPRr-së.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

4. Vendimi i dërgohet KAAPRr.

Kryetarja e KD së AKK-së
Violeta Dema